



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljepljen / Prodato Received / Delivery	08.02.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shkruar Filles Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHETI 526/2021			1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.433/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj - anëtare, si dhe Ardita Percuku Shyti - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesat me numër A.nr.421/2020 të datës 16.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. „Holger Pedersen”, Ndërtesa Vëllezërit Asllani, Blloku A1, kati VI, Nr.27, Prishtinë, si dhe ankesën A.nr.433/2020 të datës 23.12.2020, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. “Vëllezërit Gërvalla”, Fushë Kosovë, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. Prot: 1319/2020 të datës 07.12.2020 si dhe Vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. Prot: 1341/2020 të datës 09.12.2020, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër Prot: 1341/2020 i datës 09.12.2020, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ankesën me numër Nr.1105/2020 të datës 12.11.2020, të parashtruar nga ankuesja si dhe Vendimi me numër Prot: 1319/2020 i datës 07.12.2020, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ankesën me numër nr.1079/2020 të datës 10.11.2020 të parashtruar nga ankuesi

**II. OBLIGOHET** Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e ankesave të ankuesve të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Asistent-e Ekzekutiv-e” e Kryetarit/es së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe të vendosë në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje, duke marrë parasysh të gjeturat dhe konstatimet e këtij vendimi.

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsy et im

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 07.10.2020 ka shpallur konkursin me numër reference KQZ-40/2020 për pozitën "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe të dy ankuesit dhe kanë qenë kandidatë në këtë procedurë të rekrutimit.

Ankuesit, dhe te pakënaqur me njoftimin e datës 09.11.2020 për kandidaten e suksesshëm për pozitën „Asistent-e Ekzekutiv-e” e Kryetarit/es të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, brenda afatit ligjor kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas përshkrimit të datave dhe numrave të protokollit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht ankesa me numër Nr.1105/2020 e datës 12.11.2020, e parashtruar nga ankuesja dhe ankesa me numër Nr.1079/2020 e datës 10.11.2020 e parashtruar nga ankuesi

Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me date 09.12.2020 ka nxjerr vendim me numër Nr. Prot: 1341/2020 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankueses ndërsa me datë 07.12.2020 Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka nxjerre vendim me numër Nr. Prot: 1319/2020, me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankuesit

Ankuesja kundër vendimit me numër Nr. Prot: 1341/2020 të datës 09.12.2020, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , me date 23.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Nr.Prot:3272/2020, ndërsa ankuesi kundër vendimit me numër Nr. Prot: 1319/2020 të datës 07.12.2020, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me date 16.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Nr.Prot:3168/2020.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 1/2021 me të cilin ka vendosur bashkimin e ankesës me numër A.nr.421/2020 e datës 16.12.2020, e parashtruar nga ankuesi si dhe ankesës me numër A.nr.433/2020 e datës 23.12.202, e parashtruar nga ankuesja lidhur me zhvillim e procedurës së rekrutimit për pozitën "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es" së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi që objekti i ankesave është i njëjtë dhe lënda ka marr numrin A.nr.433/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 28.12.2020 respektivisht 18.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa Këshilli me datën 20.01.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve se bashku me shkresat tjera të lëndës.

Kolegji për vërtetimit e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses A.nr.433/2020, e datës 23.12.2020, me numër protokollit 3272/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit A.nr.421/2020, e datës 16.12.2020, me numër protokollit 3168/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 24.12.2020; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 07.12.2020; Ankesë drejtuar në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së i datës 10.11.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 28.12.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 20.01.2021; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 09.11.2020; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 09.12.2020; Ankesë drejtuar në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së i datës 12.11.2020; Ankesë drejtuar në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së i datës 10.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 20.01.2021; Vendim i datës 23.10.2020; E-mail nga për i datës 06.10.2020; Konkurs i datës 07.10.2020; Vendim i datës 23.10.2020; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara Form.KQZ-R-04; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara Form.KQZ-R-04; Kërkesa për punësim e kandidatit e datës 08.10.2020; Diplomë me numër nr.1476 e datës 29.08.2017; Diplomë me numër nr.3577 e datës 14.10.2015; Certifikatë e datës 23.09.2019; Certifikatë e datës 05.01.2017; Vërtetim i datës 03.12.2018; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile i datës 30.07.2020; Vërtetim i datës 12.10.2020; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit – SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 12.10.2020; CV-ja e Certifikatë e datës 08.10.2020; Diplomë me numër nr. 023/17 e datës 02.08.2017; Vërtetim i datës 24.06.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.12.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.11.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 14.09.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.08.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.07.2017; Vërtetim i datës 17.04.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 17.05.2019; Letër Rekomandim i datës 22.10.2018; Kontratë Pune e datës 01.08.2017; Vërtetim i datës 15.11.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 13.05.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.08.2017; Vërtetim i datës 30.11.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.12.2016; Vërtetim i datës 30.11.2016; Kontratë për Punë Specifike e datës 30.08.2016; Letër Referencë për nga Kontratë e Punës Praktike e datës 06.06.2016; Vërtetim i datës 30.11.2017; Vërtetim i datës 01.12.2017; Certifikatë e datës 20.07.2017; Certifikatë nga BPB për muajin Qershor-Shtator 2016; Certifikata e Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni I Personelit – SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 20.10.2020; Referencë e datës 01.07.2018; Vërtetim i datës 12.03.2019; Vërtetim i datës 03.05.2016; Certifikatë e datës 01.02.2011; Certifikatë e datës 30.03.2018; Certifikatë e datës 14.09.2016; Certifikatë për trajnimin "Hulumtime Ligjore në Internet"; Diplomë me numër nr. 3045 e datës 23.03.2015; Certifikatë e datës 10.06.2019; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit – SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidatit i datës 20.10.2020; Diplomë me numër nr. 736 e datës 20.05.2010; Pasqyra e Notave nga Kolegji AAB; Certifikatë e datës 11.07.2016; Certifikatë e datës 11.07.2016; Mirënjohje e datës 25.05.2013; Letër Rekomandim i vitit 2018; Vërtetim i datës 09.01.2020; Certifikatë e datës 30.07.2020; Letër Rekomandim i datës 10.06.2019; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni I Personelit – SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidatës 21.10.2020; Certifikatë e datës 20.10.2020; Certifikatë e datës 09.04.2019; Certifikatë e datës 19.08.2019; Certifikatë e datës 09.10.2017; Referencë Pune e datës 06.11.2018; Diplomë e datës 03.10.2016; Diplomë me numër nr.45/17 e datës 30.08.2017; Certifikatë e datës 01.01.2019; Certifikatë e datës 25.03.2019; Certifikatë e datës 06.11.2018; Certifikatë e datës

14.05.2019; Certifikatë e datës 10.12.2019; Diplomë me numër nr.318 e datës 13.07.2020; Vërtetim I datës 21.09.2020; CV-ja e Certifikatë e datës 16.04.2011; Certifikatë e datës 23.04.2011; Certifikatë e datës 27.10.2011; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 19.10.2020; Dëklaratë e datës 13.06.2020; Vërtetim I datës 15.06.2020; CV-ja e Diplomë me numër nr. 459 e datës 21.11.2008; Diplomë me numër nr. 514 e datës 26.07.2013; Certifikatë e datës 25.03.2013; Përformanca e e datës 30.04.2016; Kontratë Pune e datës 20.10.2015; Vërtetim për Përformanca e Punës e datës 29.01.2018; Certifikatë e e vitit 2018; Certifikatë e datës 13.10.2020; Certifikatë e datës 22.05.2019; Referencë e Referencë e Vërtetim Punësimi I datës 06.12.2016; Certifikatë e datës 18.12.2016; Vërtetim i datës 15.06.2020; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 21.10.2020; Diplomë me numër nr. 703 e datës 24.11.2009; Diplomë me numër nr. 1685 e datës 06.02.2018; Certifikatë e datës 21.01.2000; Certifikatë e datës 26.04.2000; Certifikatë e datës 13.09.2000; Certifikatë e datës 09.01.2015; Referencë e datës 15.09.2011; Certifikatë e datës 05.06.2020; Vërtetimi për pranimin e aplikacionit nga Divizioni I Personelit - SKQZ; Kërkesa për punësim e kandidati I datës 21.10.2020; Diplomë e datës 11.12.2019; Diplomë me numër nr. 441 e datës 25.09.2009; Certifikatë e datës 20.12.2019; Certifikatë e datës 27.03.2017; Referencë e datës 25.08.2020; Vërtetim i datës 01.06.2017; Vërtetim i datës 24.09.2009; Certifikatë e datës 23.06.2020; Raporti mbi rezultatet e testimit me shkrim I datës 02.11.2020; Testi me shkrim i kandidatës Testi me shkrim i kandidatit Jeton Parduzi; Testi me shkrim i kandidatës Testi me shkrim i kandidatës Pranvera Berisha; Testi kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Testi me shkrim i kandidatës aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë Form.KQZ-R-05 i datës 16.10.2020; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Forma.KQZ-R-07a; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Formularët.KQZ-R-08a; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form.KQZ-R-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form.KQZ-R-10; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.KQZ-R-11 i datës 06.11.2020; E-mail nga për datës 24.10.2020; E-mail nga Kreshnik Spahiu për Mërgita Kryeziu i datës 25.10.2020; E-mail nga për i datës 28.10.2020; E-mail nga për i datës 28.10.2020; E-mili nga për i datës 28.10.2020; E-mail nga për i datës 25.10.2020; Vërtetim për Plani Zhvillimor I shkollës (24) orë; Certifikatë për nga ECDL Kosova; Certifikatë për e vitit 2015; Certifikatë për e vitit 2015; Certifikatë për Emali zyrtar i datës 24.10.2020; Emali zyrtar i datës 25.10.2020; Emali zyrtar i datës 28.10.2020 si dhe vendimin për bashkimin e lëndëve Nr.1/2021, të datës 27.01.2021 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesëve të kthehet në rishqyrtim, duke e obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që të beje rishqyrtimin e ankesave të parashtruar nga ankuesit lidhur me zhvillim e procedurës së rekrutimit për pozitën "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës ka konstatuar se dy vendimet e nxjerra nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konkretisht Vendimi me numër Prot: 1341/2020 i datës 09.12.2020, lidhur me ankesën me numër Nr.1105/2020 të datës 12.11.2020, të parashtruar nga ankuesja

si dhe Vendimi me numër Prot: 1319/2020 i datës 07.12.2020, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ankesën me numër nr.1079/2020 të datës 10.11.2020 e parashtruar nga ankuesi përmbajnë të meta dhe janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil gjegjësisht procedurën administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pjesën e dispozitivit të Vendimi me numër Prot: 1341/2020 të datës 09.12.2020, ka përcaktuar si në vijim: „ *Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër Nr.1105/2020 e datës 12.11.2020, e parashtruar nga ankuesja kandidat për pozitën me numër reference KQZ-40/2020 "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es përkitazi me mos vlerësimin e drejte meritor sipas parimeve të përcaktuara ligjore ne procedurën e rekrutimit gjate krijimit te listës së ngushte*”, kurse në paragrafin e III të dispozitivit të këtij vendimi e ka shpallur veten jo kompetent, lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit, me çka Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka dështuar që të përcaktoj saktë dispozitivin duke e lënë të pazgjidhur çështjen e procedurës së rekrutimit dhe përcaktimin nëse ajo duhet të anulohet apo jo edhe pse është kompetence e KZAK-se që të vendosë për këtë çështje. Ndërsa në Vendimin me numër Prot: 1319/2020 të datës 07.12.2020, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ankesën me numër nr.1079/2020 të datës 10.11.2020 të parashtruar nga ankuesi në pjesën e dispozitivit të këtij vendimi ka përcaktuar si në vijim: *Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër nr.1079/2020 e datës 10.11.2020 e parashtruar nga ankuesi kandidat për pozitën me numër reference KQZ-40/2020 "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es*.

Andaj, duke marre parasysh faktet e lartshënuara, konkretisht faktin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KZKA) me rastin e nxjerrjes se dy vendimeve me dispozitiv të ndryshëm për objekt të njëjtë të ankesës, gjegjësisht dy vendimmarrje të ndryshme lidhur me zhvillimin e një procedure të njëjtë të rekrutimit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se KZKA ka dështuar të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me zhvillimin e rregullt apo te parregullt të procedurës së rekrutimit për pozitën *"Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es*, respektivisht ka dështuar të saktësoje se procesi i rekrutimit a është zhvilluar në kundërshtim apo në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil si dhe legjislacionin në fuqi të KQZ-së, respektivisht Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve të Sekretariatit të KQZ-së si dhe aktet tjera juridike nga fushë-veprimtaria e funksionimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si organ i pavarur kushtetues.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 07.10.2020 nga Sekretariati i Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për pozitën *"Asistent-e Ekzekutiv-e"* e Kryetarit/es se Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kriteret kryesore të konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare;*
- *Dy (2) vite përvojë pune.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i obliguar të vërtetoj saktë dhe në mënyrë të gjithanshme nëse të gjithë kandidatet që janë përfshirë në listën e shkurtër dhe kandidatja e rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil për pozitën "Asistent-e Ekzekutiv-e" e Kryetarit/es i plotësojnë kriteret kryesore të konkursit, gjegjësisht kriterin e përvojës së punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i obliguar të vërtetoj nëse Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përcaktimit të listës së shkurtër ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil si dhe legjislacionin në fuqi të KQZ-së, respektivisht Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuase të Nëpunësve të Sekretariatit të KQZ-së

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është i obliguar që me rastin e rishqyrtimit të rastit, të marr parasysh të gjeturat e këtij vendimi dhe të eliminojë të gjitha shkeljet ligjore dhe procedurale, duke shqyrtuar dhe vendosur për të gjitha pretendimet ankimore të ankueseve dhe pas analizimit të të gjitha dokumenteve të procedurës së rekrutimit duke marr parasysh dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil si dhe legjislacionin në fuqi të KQZ-së, respektivisht Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuase të Nëpunësve të Sekretariatit të KQZ-së, të marr vendim meritore për rastin e ankuesit dhe ankueses

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrativo, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.433/2020

**Ardita Percuku Shyti**

*Për Shyti*  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Malsore Gashi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Ankuesit Jeton Parduzi;
- Sekretariatit të KQZ-së;
- Udhëheqësit të Personelit të KQZ-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së